

HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE EFEKTET E AKTEVE NORMATIVE ME FUQINË E LIGJIT

Rast Studimor

NGA GERTI SHELLA

EKSPERT PER BOTIMET ZYRTARE

Gjatë kohës që implementohej ky studim, GJK mori në shqyrtim kërkesën e një grupi prej 36 deputetësh, me objekt: *Shfuqizim, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të aktit normativ të KM nr.5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*; **Vendimi i marrë nga GJK më dt. 5 shkurt 2014 shfuqizoi si antikushtetues Aktin Normativ me Fuqinë e Ligjit nr 5.**

Që në fillim të Janarit 2014, mediat, në mëse një rast, botuan projekt-vendimin e GJK², ku tashmë ishin të përvijuar qartë linjat e arsytimit të shumicës (5 gjyqtarë). Sipas këtyr mediave, vendimi (në kuptimin e dispozitivit) duhet të jetë arritur nga fillimi i Dhjetorit 2013, kohë në të cilën akti normativ i qeverisë ishte kthyer në ligj³ të zakonshëm nga Kuvendi. Për më tepër, akti normativ kishte prodhuar efektet e synuar që në datën e nxjerrjes së tij, për shkak të vetë natyrës së tij. Konkretisht, akti normativ nr. 5/2013, i cili shtyu me 6 muaj hyrjen në fuqi të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, u miratuar nga KM në dt. 30 Shtator 2013, në një kohë që afati i caktuar (me konsensus) për hyrjen në fuqi të ligjit në fjalë ishte data 1 Tetor 2013.

1 Objekti i plotë: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 Për nëpunësin civil; Shfuqizimi i ligjit nr.161/2013 Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013 Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 Për nëpunësin civil; Përzullimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese

2 Shih gazeta “MAPO”, kryeartikulli i nr 1102, e marte, 7 janr 2014 nga Fejzi Braushi; shih edhe Revista Java, nr...dt...

3 ligj nr.161/2013, dt datë 17.10.2013 “Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013”

HYRJA NE FUQI E VENDIMEVE TE GJKATES KUSHTETUESE

Vendimi i GJK nr.5/2014 u shpall i arsyetuar përmes leximit në seancë (sallë), konform përcaktimit ligjor⁴. Në dispozitivin e këtij vendimi (fjalë e tretë), përcaktohej shprehimisht se *vendimi është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare*. Ky përcaktim është konform Kushtetutës e cila përcakton se *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare* (neni 132).

Pavarësisht se GJK e shpalli të arsyetuar vendimin në fjalë solemnisht dhe në prani të palëve, dhe pavarësisht se ajo vetë e publikoi atë menjëherë pas shpalljes në faqen e saj zyrtare⁵, vendimi duhej të priste akoma shumë ditë për të hyrë në fuqi. Për aq sa mund të tingëllojë e çuditshme, futjen në fuqi të një vendimi të GJK e ka në dorë një institucion qeveritar varësie, që quhet Qendra e Botimeve Zyrtare (shkurt: QBZ). Kjo e fundit e botoi vendimin në fjalë vetëm pasi kaluan plot 21 ditë nga shpallja e tij prej GJK. Vendimi u botua në Fletoren Zyrtare nr.18, të datës 26 Shkurt 2014. Kjo përbën një nga vonesat më të gjatë të vërejtura, krahasuar me të gjitha vendimet e tjera të GJK gjatë vitit 2013⁶. Që nga momenti i shpalljes së vendimit e deri në botimin e tij, QBZ nxorri në qarkullim 9 Fletore Zyrtare, një pjesë e së cilave procesuan për botim akte me datë lëshimi më të vonë se ajo e vendimit të GJK nr.5/2014. Kjo kohë mund të kishte qenë edhe më e zgjatur, nëse aktorët e interesuar nuk do të kishin shtuar progresivisht presionin publik nga Qeverisë që kjo e fundit “të lejonte” botimin e vendimit të GJK në Fletore Zyrtare.

Teorikisht, në këtë teatër institucional, edhe hapja e siparit (nxjerrja e aktit normativ), edhe mbyllja e tij (hyrja në fuqi e vendimit të GJK përmes botimit në FZ) lëvizet prej duarve të Qeverisë. Vetë Gjykata Kushtetuese nuk është më një aktor, por një spektator, kur luhet “akti i fundit”, ai i futjes në fuqi të vendimeve të saj.

Kur flitet për hyrjen në fuqi të një vendimi të GJK, sidomos në rastet kur kjo e fundit shqyrton kushtetutshmërinë e një *akti normativ me fuqinë e ligjit*, ka një seri çështjes dhe disa pikëpyetjesh që meritojnë vëmendje dhe kujdes. Së pari, nisur nga natyra e vetë aktit normativ me fuqinë e ligjit, i cili i fillon efektet menjëherë, a ka vend të pretendohet edhe nga GJK e njëjta urgjencë në shqyrtimin çështjes? Së dyti, a janë të efektshme dhe a kanë dobi materiale këto vendime të GJK⁷ jashtë një konteksti të përcaktuar kohor? A është normale që GJK të mos i

4 Neni 72 “Marrja e vendimit dhe shpallja e tij”, L I G J Nr.8577, dt. 10.2.2000 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

5 Shih ketu: http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

6 Gjatë vitit 2013, GJK ka dërgua për botim në Fletore zyrtare 55 vendime përfundimtare. Të gjitha këto vendime nuk e kalojnë afatin 15 ditor nga shpallja e tyre deri në dotim, me përjashtim të vendimit nr 48, i cili është botuar 19 ditë pas shpalljes (FZ 189, dt 4.12.2013)

7 Kur objekt shqyrtimi janë aktete normative me fuqinë e ligjit që nxjerr KM

jepet (apo të mos marrë përsipër) “rol” lidhur me futjen në fuqi të vendimeve të saj kur ato shfuqizojnë dekretligje qeveritare? A ka në thelb një konflikt interesi në rastin kur Qeveria “ngarkohet” të botojë në Fletore Zyrtare vendime të GJK që rrëzojnë dekret-ligjet e saj? A ka tek e fundit kuptim fraza standard: “*GJK vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm më Kushtetutën të aktit normativ me fuqinë e ligjit*”?!

Rasti në fjalë, pra vendimi i GJK nr.5/2014 dhe çështja që lidhet me hyrjen e tij në fuqi, ofron një terren mjaft interesant për nisjen e një analize që synon t’i përgjigjet pyetjeve të mësipërme. Analiza e mëposhte është sa hipotetike aq edhe praktike, duke supozuar në secilin rast vetëm opsione të mundshme të ndërveprimit institucional.

* * *

Le të supozojmë fillimisht se GJK e ka nisur për botim vendimin nr.5/2014 në QBZ. Vendimi në fjalë duhet të niset drejt QBZ për botim brenda 5 ditëve, pasi kaq është afati maksimal që i caktohet nga ligji për QBZ (ligji nr. 96/2012) institucioneve që nxjerrin akte të botueshme. Vetë ligji organik i GJK nuk përcakton asnjë afat brenda të cilit ky institucion qëndror kushtetues të nisë për botim në Fletore Zyrtare vendimet që nxjerr. Kjo është edhe arsyeja që ky paragraf nis me togfjalëshin “*le të supozojmë*”, pasi, teorikisht GJK mund të zgjedhë “t’i bindet” vetëm ligjit të saj organik (me 3/5) dhe t’i dërgojë vendimet për botim në cilëndo kohë që ajo e vlerëson të arsyeshme, pa iu “nënshtruar” detyrimit që buron për të nga ligji i thjeshtë (50+1), i një institucioni varësie siç është QBZ.

Pra, nëse GJK e ka nisur për botim vendimin 5/2014, përgjegjësia për mosbotimin e tij në Fletore Zyrtare përtej një afti 10 ditor bie mbi QBZ. Kjo e fundi është institucioni përgjegjës për realizimin e botimit të Fletores Zyrtare, duke mundësuar hyrjen në fuqi të akteve të botueshme, si dhe njohjen e tyre nga publiku⁸. Pra, nëse QBZ, (nëse Qeveria) “do kishte dashur vërtet”, vendimi i GJK do ishte botuar në Fletore Zyrtare që ditën e parë të mbërritjes. Vetë QBZ funksion tashmë mbi bazën e një ligji të ri, i cili, pikërisht për të shpejtuar procese të tilla, ka parashikuar hyrjen në fuqi të akteve përmes botimit elektronik të Fletores Zyrtare. Aktet madje mund të dërgohen elektronikisht për botim⁹. A nuk u botua vetë akti normativ nr. 5 i KM menjëherë ditën që doli (FZ 159, dt.30/09/2013)?! Fletore Zyrtare në fjalë përmban vetëm aktin normativ nr.5, i cili zë vetëm një faqe; është një nga edicionet e rralla ku një FZ del në qarkullim vetëm me 2 fletë.

Në rastin konkret, Qeveria është treguar madje më “orthodokse” se vetë GJK (tingëllon më mirë se: më “katolike” se Papa). Kjo e fundit përmes jurisprudencës së saj, i ka lejuar Qeverisë “luksin” që, posaçërisht dekretligjet e saj, të mund t’i

8 neni 4, para.2, ligji 96/2012 “Per Qendrën e Botimeve Zyrtare”, FZ. 140, 31 Tetor, 2012.

9 Neni 5 **Dërgimi i akteve për botim, paragrafi 1**: Teksti i akteve të botueshme i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare në formatin e shkruar në letër dhe në format elektronik brenda 5 ditëve pas miratimit nga institucionet shtetërore përkatëse.

botojë në një kohë të dytë pasi ato të kenë hyrë në fuqi¹⁰. Padyshim që ky është një nga interpretimet e GJK që, në vlerësimin e autorit të kësaj trajtese, rri nën lartësinë jurisprudencës së saj, nisur nga rrethana statike se, në fund të fund GJK ka mision interpretimin e Kushtetutës, e cila, në nenin 117 të saj e thotë shqip dhe prerë se: *“Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”*. (Vetë precedenti i botimit të mënjehershëm të aktit normativ nr.5 në Fletore Zyrtare 159, është prova e gjallë që GJK ka arsyetuar gabim kur i ka lejuar Ekzekutivit këtë prerogativ që bie haptazi ndesh me Kushtetutën).

Tani, le të supozojmë të kundërtën, pra që GJK nuk e ka dërguar për botim në FZ vendimin e saj nr. 5. Siç u përmend edhe më sipër, ligjvënësi nuk i ka caktuar GJK asnjë afat afat në ligjin e saj brenda të cilit ajo dërgon për botim në Fletore Zyrtare vendimet që nxjerr. Ligji i GJK përcakton vetëm se: *“Organi që boton Fletoren Zyrtare detyrohet të bëjë botimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 15 ditë nga ardhja për botim e tyre pranë atij organi”* (neni 26, para. 2). Pra, shihet qartë se kjo dispozitë kujdeset të caktojë afat për QBZ, por “harron” të caktojë më së pari një fat për vetë GJK. Duhet mbajtur parasysh se hyrja në fuqi e një akti përmes botimit në Fletore Zyrtare implikon një marrdhënie “dërgues-marrës”, në rastin konkret të GJK dhe QBZ. Kjo e fundit funksionon me ligj të veçantë (nr. 96/2012) dhe afatet brenda të cilave QBZ duhet të botojë aktet e institucionit “dërgues”, janë të rregulluara nga ligji i saj. Kjo specifike, pra që edhe dërguesit i duhet caktuar afat, është mbajtur mirë parasysh nga ligjvënësi në rastin e ligjit për Gjykatën e Lartë, ku përcaktohet shprehimisht se *“Vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore botohen në numrin më të parë të Fletores Zyrtare”*.

Paradoksalisht, në marrdhënien mes GJK dhe QBZ, ligjvënësi ka zgjedhur që afatet e “dërguesit” t’i caktojë në ligjin e “marrësit” dhe anasjelltas; afatet e “marrësit”, t’i caktojë në ligjin e “dërguesit”. Konkretisht, ligji i GJK i cakton 15 ditë afat QBZ të bëjë botimin e vendimeve të saj, kurse ligji i QBZ i ve 5 ditë afat GJK të dërgojë për botim në Fletore Zyrtare vendimet e saj. Për më tepër, edhe rakordimi (sikronizimi) i këtyre afateve *sureale* është një ushtrim me vetë! Ligji për QBZ e detyron këtë të fundit të bëjë botimin e akteve jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e tyre¹¹. Kurse ligji për GJK (8577) i cakton QBZ 15 ditë afat që ajo të botojë vendimet e saj?! Rasti në fjalë dikton nevojën për harmonizim mes këtyre dy ligjeve, edhe sikur vetëm për rakordimin të afateve.

Në një kuptim më të zgjeruar, është e dukshme domosdosmëria e ndërhyrjes në

10 ?????

11 Ligji nr. 96/2012, Neni 6 “Afati i botimit”

1. Aktet e botueshme duhet të botohen pa vonesë pas përpunimit për botim, por sidoqoftë jo më vonë se 10 ditë nga data e ardhjes tyre, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

2. Në rast të masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë dhe urgjence, Ministri i Drejtësisë urdhëron botimin e aktit brenda një afati më të shkurtër se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Kushtetutë ose në ligjin për GJK (nr. 8577/2000), me qëllim caktimin e qartë të afateve direkte për hyrjen në fuqi të vendimeve të GJK. Nëse do të duhej të prekej ligji, mund të përdorej formulimi: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi pas botimit në numrin më të parë të Fletores Zyrtare nga data e shpalljes së tyre”. Një përcaktim i tillë do të prodhonte një detyrim të dyfishtë për vetë GJK dhe për QBZ. Nëse i referohemi rastit konkret të vendimit të GJK 5/2014, numri më i parë i fletores zyrtare, me një përlogaritje pothuajse të saktë, do të ishte ajo me numër 10, e datës 6 Shkurt 2014.

Nëse përmirësimi do të zgjidhej të bëhej në Kushtetutë, dispozitat e nenit 132 mund të ri-formuloheshin ndoshta në këtë mënyrë: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi me shpalljen e tyre dhe botohen në Fletore Zyrtare”.

Është logjike të pretendohet që, kur GJK shqyrton kushtetutshmërinë e dekretligjeve, vendimet e saj të hyjnë në fuqi me shpalljen e tyre, njësoj sikurse ligji i saj (jo kushtetuta) ia lejon për vendime që mbrojnë të drejtat kushtetuese të individit. Në një rast të tillë, GJK “paradoksalisht, por me të drejtë” e kapërcen kufirin që vendos neni 132 i Kushtetutës, i cili parashikon se: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”. Për atë që kjo mund të legjitimohet, duhet pohuar se mbrojtja e të drejtave kushtetuese të individit është në shumicën e rasteve *time-sensitive*, nganjëherë në masë të tillë sa çdo vonesë që lidhet me praktikën e përgatitjes dhe nxjerrjes për botim të një numri standard të fletores zyrtare mund të thellonte objektivist shkëlqen e këtyre të drejtave. Për analogji, efektet e prodhuara nga një akt normativ mund të jenë edhe më tepër *time-sensitive*, madje me impakt jo thjesht mbi një individ, por mbi grupe të tëra shoqërore, të cilët, po njësoj kanë të drejtë të gëzojnë garancitë kushtetuese dhe ligjore. E drejta për punë, **jetese etj**, me të cilat akti normativ në fjalë mendohet se ka rezonuar negativisht, janë të drejta kushtetuese gjithashtu.

Po le ta harrojmë për një çast “lëmshin” ku janë ngatërruar afatet e hyrjes në fuqi të vendimeve të GJK dhe të lexojmë shqip nenin 72 të ligjit të saj, i cili në pikën 4 dhe 7 të tij përcakton: (4.) Për shpalljen e vendimit njoftohen pjesëmarrësit në proces. Mungesa e tyre nuk pengon shpalljen e tij; (7.) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar. Kur lexon këto përcaktime, një mendje me një minimum arsyeje do të pyeste: **e përse duhet që, pasi i është shpallur dhe lexuar në sy palëve vendimi i gjykatës, ato të presin që ai të hyjë në fuqi pas botimit në fletore zyrtare ?!**

Fletorja Zyrtare është padyshim dokumenti zyrtar ku duhet të botohet jurisprudenca e GJK, pasi vetëm kështu ajo referohet zyrtarisht, por FZ në vetvete jo domosdoshmërisht duhet të caktojë kohën e hyrjes në fuqi të një akti, në rastin konkret të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Në praktikë, botimi në Fletore Zyrtare i një akti normativ (në kuptimin e gjerë të termit) thjesht prezumon njoftimin zyrtar të palëve të interesuara mbi normën e re, në mënyrë që “nesër”

askush të mos pretendojë se nuk ishte njohur me të. Për aktet individuale, pra që adresojnë subjekte të identifikueshëm, hyrja në fuqi e tyre mund të nisë me marrjen njoftim të palëve që vetë akti adreson. Për analogji, shumica dërrmuese e vendimeve individuale të Këshillit të Ministrave hyrje në fuqi menjëherë dhe më pas botohen në Fletore Zyrtare. Botimi në këtë rast realizohet që palët e treta, jo lehtësisht të identifikueshme, të marrin njoftim zyrtar që të përftojnë apo mos-dëmtohen nga afektet që sjell akti i miratuar. Kjo praktikë madje është e parashikuar qartë në ligjin nr. 9000, dt.3/1/2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Neni 29/2, fjalia e fundit, përcakton se: “Për vendimet me karakter normativ mund të caktohet si date hyrjeje në fuqi një datë tjetër nga ajo e botimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa vendimet me karakter individual hyjnë në fuqi menjëherë, por botohen në Fletoren Zyrtare.”

Për t’u kthyer tek vendimet e GJK, sa kohë ato shpallen të arsyetuara në seancë, në prani të palëve, të cilat marin dijani në sallë për këtë vendim, hyrja në fuqi e tyre përmes botimit në FZ veçse komplikon procesin, sidomos kur vendimi i GJK lidhet me rrezimin e akteve të cilave kanë filluar të prodhojnë efekte që nga momenti i nxjerrjes së tyre. Hyrja në fuqi e vendimeve të GJ duhet të ndahet nga botimi i tyre në FZ; botimi mund të realizohet në një kohë të dytë nga hyrja në fuqi e vendimit, në mënyrë që edhe palë të tjera të interesuara të marrin dijani mbi normën / jurisprudencën më të re të GJK.

PRAPESIMI I EFEKTEVE TE AKTIT NORMATIV ME FUQINE E LIGJIT

Dekretligji i parë i qeverisë “Rama” kishte fatin e keq që të ishte edhe dekretligji i parë anti-kushtetues i saj. Por ky fakt nuk surprizon! Çështja e akteve normative me fuqinë e ligjit të cilat “zh”vlerësohen si të papajtueshëm me Kushtetutën nga GJK është tashmë një sëmundje kronike (sistemike). Ajo “përkeqësohet” gjithmonë në periudhat e instalimit të qeverive të reja pas rotacioneve. Pas ardhjes në pushtet të së djathtës 2005, GJK gjeti në mos-pajtim me Kushtetutën mbi gjysëm dyzine aktesh normative të qeverisë Berisha nxjerrë brenda 12 muajve të parë të mandatit të saj. Me sa duket, qeveritë, në statet parake, nuk rriten dot pa pirë qumështin e dekretligjeve, sado toksike qofshin efektet e këtij burimi të së drejtës.

Nëse çështja e afteteve për hyrjen në fuqi të vendimeve të GJ është si një ngërç paralizues krahasuar më shpejtësisë me të cilën Qeveria nxjerr dhe fut në veprim dekretligjet e saj, çështja e prapësimit me vendim të GJK të efekteve të prodhuara nga dekretligjet është si të ngjallësh një të vdekur pas varrimit. Konkretisht, GJK e hodhi poshtë aktin normativ nr.5 por prapësimi i efekteve të tij mbetet për t’u parë. Dëmi i supozuar është shkaktuar tashmë, për shkak të natyrës urgjente të vetë dekretligjit, dhe as vendimi i GJK, e as doktrina nuk ofrojnë zgjidhje për rikuperim, e aq më pak për rikuperim po aq të shpejtë sa e shkaktonte akti

normativ. Shëmbja e nën-kalimi të Zogut të Zi, pasojë direkte e një akti normativ, nuk është rikuperuar as sot e kësaj dite në terma të (zh)bërjes së dëmit.

Këto efekte, mund të ishin sadopak të frenueshme nëse GJK i caktohej me/në ligj detyrimi që dekretligjet të shqyrtoheshin prej saj, kryesisht ose me kërkesë “të ngutshme” nga një palë e legjitimuar, para ose paralelisht me procesin legjislativ që aktivizohet në Kuvend. Një atribut të tillë GJK e ka kur shqyrton pajtueshmërinë me Kushtetutën të marrëveshjeve ndërkombëtare, para ratifikimit të tyre nga Kuvendi (Neni 52/1). Madje, në një rast të tillë ligji i cakton asaj 1 muaj afat të vendosë për marrëveshjen, duke pezulluar gjatë kësaj kohe procesin legjislativ të ratifikimit, nëse ky ka nisur ndërkohë në Kuvend. Në fakt, ky ka qenë rasti “fatlum” i vlerësimit paraprakisht nga GJK të asaj që u njoh si Marrëveshja e Detit mes Shqipërisë e Greqisë, e cila u hodh poshtë si e papajtueshme me Kushtetutën, para se të ratifikohej nga Kuvendi.

Njësoj si për marrëveshjet ndërkombëtare para ratifikimit, edhe për aktet normative me fuqinë e ligjit GJK duhet të lejohet të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën, para se efektet e prodhuara të intensifikohen deri në pakthyeshmëri. I vetmi ndryshim në rastin e shqyrtimit të akteve normative, ndoshta do të duhej të ishte ngushtimi drastik i afateve brenda të cilave GJK duhet të shprehet. A nuk ka edhe vetë Kuvendi 45 ditë kohë brenda të cilave duhet të shprehet mbi një akt Normativ? Pse GJK, që është gjithashtu një legjislator (negativ) mund të marrë kohë aq sa ajo vetë e gjykon të nevojshme, pra pa një limit ligjor, për t’u shprehur mbi një çështje urgjente, siç është në thelb një dekret-ligj qeveritar? Ky raport duhet përmbysur! Vetëm në një rast të tillë, drejtësia e shërbyer nga kjo Gjykatë mund të konsiderohet e efektshme dhe mbi të gjitha e dobishme. Drejtësia e vonuar është drejtësi e munguar, dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së dekretligjeve qeveritare është rasti më tipik kur **vonesa** prodhon **mungesë**.

Aktualisht GJK vijon t’i ketë “duart e lidhura” nga ligjvënësi, sa kohë që ky i fundit nuk përmirëson ligjin mbi të cilin kjo gjykatë funksionon! Edhe GJK vetë mesa duket nuk ka qejf të lëvizë energjikisht kur vendoset në këtë pozicion (*mund të ndihmonte veten psh. me nenin 45*). Nuk ka madje as përpjekje nga vetë GJK që kjo histori aspak dinjitoze në raportet e saj me Ekzekutivin, të frenohet përmes amendimeve që ajo vetë mund të propozojë në ligjin e saj organik.

Imagjinoni për një çast sikur qeveria t’i falte me akt normativ detin një fqinji, apo të vendoste për një tjetër çështje sensitive në marrdhëniet mes vendeve. A nuk u përgjigj përfaqësuesja e qeverisë se me akt normativ mund të ndryshohet edhe vetë Kushtetuta po të lindë një nevojë e tillë për kryeministrin? Le të supozojme diçka më të thjeshtë: shfuqizimin me akt normativ vetëm për ca kohë të ligjin për GJK, apo për Gjykatën e Lartë, apo për ndonjë gjykatë tjetër...sigurisht, ky do të ishte tritoli që këtë herë do të hidhte në erë rendin kushtetues. Dhe në këtë rast, fitili do të ndizej “**nga eshka që digjet ngadalë**” e vetë Gjykatës Kushtetuese.